

**DRAFTI I**  
**RAPORTIT TE VLERESIMIT TE**  
**NDIKIMIT NE MJEDIS**  
**TE AKTIVITETIT**

**"Mbareshtim I lopeve dhe prodhim i qumeshtit"**



**Subjekti :** "VJEN" Sh.p.k  
**Hartoi:** "EKO-STUDIO-PROJEKT"sh.p.k  
**Administrator :** Shkelzen MADANI



**Tirane 2019**

## PERMBAJTJA

✚ Hyrje

✚ Baza ligjore

✚ Metodika e vleresimit te mjedisit

✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobeseve ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

### **"Mbareshtim i lopeve dhe prodhim i qumeshtit"**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te*



*hollesishme per shyrtrimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

➤ **Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se**

Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jape nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti: ”Vjen” shpk , eshte regjistruar ne QKB me nr NIPT : K34224402, me vendndodhje ndodhet ne fshatin Grabjan Bashkia Divjake, rrethi Lushnje, qarku Fier. Ferma ”Vjen” shpk operon ne fushen e mbareshtimit te lopeve prej shume vitesh, duke qene element i rendesishme dhe faktor ekonomik per zhvillimin e zones dhe jo vetem. Aktiviteti I prodhimit te qumeshtit ka ardhur ne rritje, ne baze te kerkeses se tregut dhe konsumatoreve ndaj Ferma ”Vjen” zgjeruar siperfaqen e mbareshtimit te kafsheve duke ndertuar nje stalle si vazhdim I stalles se vjeter me nje kapacitet prej 380 kreresh I ndertuar me teknologjine bashkekohore te funksionimit te stalles dhe te ndertimit . Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B referuar ligjit 60/2014 date 19.06.2014, per nje ndryshim ne ligjin 10 448 per Lejet e Mjedisit.

## **Pershkrimi i projektit**

Ferma “Vjen” shpk eshte nje kompleks i cili ushtron aktivitetin e mbarshimit te lopeve per prodhimin e qumeshtit duke ruajtur distancat urbane me ambientin perreth gjithashtu edhe me objektet. Stalles ekzistuese i eshte shtuar nje siperfaqe e cila perdoret per shtimin e lopeve me qellim prodhimin e qumeshtit pasuar dhe nga nje sere aktivitetesh si me poshte :

1. *Stalla e lopeve*
2. *Materniteti*
3. *Zona e ushqimit*
4. *Impjanti i mjeljes*
5. *Bokset e vicave*
6. *Depozitat e qumeshtit*
7. *Dhome punonjesish*
8. *Laborator*
9. *Zyra, magazina dhe nyjet sanitare (kati i pare)*

### ***Menyra e te ushqyerit***

Të ushqyerit e lopëve ka ndikim të madh në profitabilitetin e fermave për prodhimin e qumështit. Për të pasur një prodhimtari optimale të qumështit, racionet duhet të jenë mirë të balancuara. Me sigurimin e sasisë dhe cilësisë se ushqimit lopët qumështore mund të prodhojnë qumësht në bazë të kapacitetit gjenetik që kanë dhe të mbajnë mirë shëndetin e tyre. Racioni duhet të plotësojë kërkesat në energji dhe proteina, për mirëmbajtje, prodhim të qumështit, rritje dhe riprodhim. Një racion komplet duhet të plotësojë kërkesat me sasi adekuate të mineraleve dhe vitaminave. Racioni duhet të përmbajë ushqime voluminoze për tretje optimale në rumen dhe në përbërjen e qumështit. Sasia e ushqimeve fibroze në racion duhet të jetë së paku një e treta e materies se thatë totale ditore për të parandaluar çrregullimet digjестive. Prandaj, ushqimet e thata sikurse llojet e ndryshme të sanës, barit dhe silazhe se misrit duhet të formojnë bazën e një racioni të mirë. Po ashtu racioni duhet të jetë i shijshëm dhe tërheqës për lopën. Shumica e rasteve të çrregullimeve metabolike ndodhin gjatë mbarshimit dhe 6-8 jave pas pjelljes. Kjo është periudhë kur lopa është nën një stres të nivelit të lartë. Niveli i ushqimit dhe përbërja e tij para dhe pas pjelljes është i rëndësishëm së lartë për mirëmbajtjen e shëndetit të mirë. Racioni nuk duhet të afektojë shijen e qumështit, sepse qumështi i freskët duhet të jetë pa kundërmime ose aroma të pakëndshme

### ***Procesi teknologjik***

Stalla per lope qumeshtore: Skema e organizmit te vendosjes se shtreterve eshte pozicionuar e tille qe te leri hapesiren funksionale per levizjen e lire te kafsheve, koridori i kalimit, ne te cilin kalon rrasketa e pastrimit te plehut vazhdon gjate gjithë gjatesise se stalles pa u nderprere. Zona e ushqimit eshte pozicionuar ne pjeset anesore duke lehtesuar edhe furnizimin me ushqim nga pjesa e jashtme, ku makineria kalon lirshem dhe pa problem. Ne fund te stalles ne pjesen



veriore te objektit eshte ndertuar kanali ku derdhen rasketat e plehut, kanali ka pjerresi dhe zgjatet ne drejtim te gropes septike per te depozituar mbetjet e mbledhura.

Kushtet e ventilimit : Ventilimi i mirë është një prej parakushteve për mbajtjen e një mjedisi paster dhe komod per fermenten.. Ventilimi ka efekt të madh në mirëqenjen, shëndetin e kafshëve, dhe në performancën e përgjithshme. Kushtet në stalle duhet të krijohen në ate menyre që kafshet të kene me të lehtë për të mbajtur dhe kontrolluar temperaturën e vet. Per tu arritur kete stalle duhet të kete hapsira të mjaftushme për hyrjen e ajrit të fresket dhe largimin e ajrit të ndotur nën çdo kusht të motit dhe gjatë një periudhe të gjatë kohore, Ventilimi i pershtatshem është i nevojshëm për largimin e gazrave të dëmshme, si dioksid karboni, amoniaku, metani, gazi sulfuror, largimin e lagështisë dhe largimin e nxehtësisë së del nga kafshët. Duhet te kihet ne konsiderat qe një lopë lëshon afër 12 litra ujë ne trajte avulli gati për çdo ditë. Po ashtu dioksidi i karbonit dhe gazi sulfuror jane me te rende se ajri dhe qendrojne ne nivelin e poshtem te stalles, ndersa amoniaku dhe metani duke qene me të lehte se ajri shperndahen nga dyshemeja ne drejtim të tavanit, prandaj është me rendesi të bëhet ventilimi në kulmin e fermes. Ventilimi i dobët mund të shkaktojë përveç problemeve shëndetësore të kafshëve edhe në demtimin e hershëm të komponentëve strukturorë të ndërtesës. Në thelb, qëllimi është për të pasur një mjedis të thatë, relativisht të lirë nga rrymat e tepërta në dimër dhe ventilim të mirë gjatë motit të ngrohtë. Lopët mund të durojnë temperatura të ulëta, duke siguruar që këto stalla të jenë të thata dhe të lira nga rrymat e ajrit. Për të krijuar një mjedis ideal temperatura e brendshme e stallave duhet të mbahet në mes  $-10^{\circ}$  C dhe  $20^{\circ}$  C. Temperatura optimale është rreth  $10^{\circ}$  C. Me rritjen e temperaturave në stallë bëhet më vështirë për kafshët për të larguar nxehtësinë e emetar prej tyre. Në këtë rast lopët qumështore do të konsumojnë më pak ushqim në mënyrë që ta ulin nxehtësinë e emetuar nga ato, dhe kjo rezulton në prodhimin më të ulët të qumështit. Prandaj largimi i nxehtësisë luan një rol të rëndësishëm në ventilim. Shumica e sistemeve të ventilimit janë të dizajnuara në përdorimin e ventilimit natyror. Lëvizja natyrore e ajrit është bazuar në parimin që ajri i nxehtë është më i lehtë se ajri i ftohtë. Ajri brenda fermave është ngrohur nga prodhimi i nxehtësisë nga kafshët. Ajri i ngrohtë ngrihet në tavan të fermës dhe për pasojë krijon një presion më të ulët ajror mbi kafshët. Kështu ajri i freskët hyn në fermë përmes dritareve për ventilim. Në kete rast duhet të kemi kujdes që në stallë mos të krjohet rryma ajrit. Nëse ka rryma ajeri, temperatura e kafshëve do të ulet papritur dhe kjo ndikon negativisht në shëndetin e kafshëve. Per te permiresuar ventilimi do te vendosen edhe ventilator qe do te kapen ne pjesen e mbuleses se konstruksionit si ne imazhin e bashakgjitur.

### ***Prodhimi i qumeshtit***

Ferma vjen nuk ben perpunim apo pastrim te qumeshtit por vetem depozitim ne depozitat e montuara enkas per depozitim e qumeshtit. Ne kete ferme ka laborator vetem per analizimin e qumeshtit. Pastaj qumeshti i depozituar shperndahet tek tregetar te cilet vijne dhe e terheqin ne ferme.

## **1. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Gjeologjia e rajonit**

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfera me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuaternar Q<sub>4</sub>AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.

### **Klima**

Klima është mesdhetare dhe është një klime jo shume e qendrueshme sepse ka shume kontraste midis stineve.

- Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 21 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e janarit është 5 °C.
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 30 °C.
- Temperatura minimale absolute është -1 °C.
- Temperatura maksimale absolute është + 38 °C.

Reshjet bien kryesisht ne stinën e pranverës. Reshjet e dëborës janë te rralla ne këtë vend. Reshjet e breshërit bien me shume ne stinën e pranverës. Takohen deri ne 3 dite me breshër ne vit. Ngricat janë te rralla. Takohen deri 10 dite me ngrica ne vit. Ngricat e para shfaqen ne muajin janar ndërsa te fundit ne muajin mars. Periudha e thatësisirës zgjat rreth 90 dite ne vit. Ka pasur raste edhe te thatesirave te tejzgjatura dhe kane qene rreth 3 raste ne 10 vjet. Era është e shpeshtë. Erërat dominuese te gjysmës se ngrohte te vitit vijnë nga jugu ndërsa te gjysjmes se ftohte nga veriu. Ne Divjakë nuk mungon edhe rasti i stuhive. Ato ndodhin me shpesh ne mars dhe numërohen mesatarisht 2 dite me stuhi ne vit. Demet qe kane sjelle stupite kane qene : rrëzimi i drithërave, rrëzimi i pemëve te vjetra qe shpesh here shkaktonte edhe rrëzimin e linjave elektrike.



### **Trashegimia arkitektonike**

Aktiviteti që kryhet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte të trashëguara dhe të ndertuara nga njeriu me rëndësi historike, sepse në këto zone ato nuk ekzistojnë. Është për t'u theksuar se në këto zone nuk ka monumente kulturore, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

### **Flora dhe fauna**

Bota natyrore bimë dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimësh e kafshësh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshësh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikësh e gjarprinjsh. Ndërsa në ujërat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret përbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim të perhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Në këtë nenkat bimor rriten edhe disa drurë të lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, që në disa raste formojnë pyje të vegjël.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

#### **Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)**

Ky vlerësim kryhet në bazë të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe kërkesave të VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe ka si synim identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparesi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- **Mbetjet e ngurta**

Drejtuësit e kompanisë kanë vendosur kosha për mbetjet të cilat vijnë si rezultat i punonjësve apo që nuk konsiderohen të "rrezikshme", ku me pas ato do të merren nga personat kompetent të vendosur nga pushteti vendor. Përsa i përket mbetjeve nga aktiviteti ato janë mbetje nga



jashteqitjet e kafsheve te cilat grumbullohen thahen dhe perdoren per pleh per te mbjellat e vet subjektit gjithashtu ju jepen edhe fermereve te zones te cilet vijne rregullisht dhe e terheqin.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret per sherbime higjieno-sanitare per stafin e punes i cili do te kaloj ne rrjetin e kanalizimeve te zones. Uji i cili do te perdoret per larjen e ambienteve te aktivitetit nuk perdoret per stallat por vetem per larjen e objekteve ndihmese te aktivitetit si dhe pastrimin e depozitave te qumeshtit keto ujra kalojne ne rrjetin e kanalizimeve.

- **Shkarkimet ne ajer**

Zhvillimi i aktivitetit te lartpermendur nuk ka gjenerime ndotese ne ajer, por vetem aromat te cilat vijne nga kafshet. Per kete subjekti ne kapanonin e ndertuar ka vendosur ventilatore te cilet do te bejne te mundur uljen e ketyre aromave gjithashtu edhe mosdaljen jashte perimetrit te aktivitetit.

- **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e transportit te cilat do te bejne transportin e kafsheve si dhe qumeshtit, por keto zhurma jane brenda normave te lejuara per nje aktivitet te tille.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e administratorit jane marre masat per mbrojtjen ne rast rrenie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e punes jane vendosur ne vende te dukshme fikset konform rregullave te sigurise.

#### **4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

- **Territori perreth objektit**

I gjithe territori i objektit dhe rruga hyrese ne te eshte e shtruar dhe e sistemuar. Jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth aktivitetit duke bere te mundur mbjelljen me bimesi.

- **Mbetjet e ngurta**

Drejtuesit e kompanise kane vendosur kosha per mbetjet te cilat vijne si rezultat i punonjesve apo qe nuk konsiderohen te ‘rrezikshme’, ku me pas ato do te merren nga personat kompetent te vendosur nga pushteti vendor. Persa i perket mbetjeve nga aktiviteti ato jane mbetejet nga

jashteqitjet e kafsheve te cilat grumbullohen thahen dhe perdoren per pleh per te mbjellat e vet subjektit gjithashtu ju jepen edhe fermereve te zones te cilet vijne rregullisht dhe e terheqin.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret per sherbime higjieno-sanitare per stafin e punes i cili do te kaloj ne rrjetin e kanalizimeve te zones. Uji i cili do te perdoret per larjen e ambjenteve te aktivitetit nuk perdoret per stallat por vetem per larjen e objekteve ndihmese te aktivitetit si dhe pastrimin e depozitave te qumeshtit keto ujra kalojne ne rrjetin e kanalizimeve.

- **Shkarkimet ne ajer**

Zhvillimi i aktivitetit te lartpermendur nuk ka gjenerime ndotese ne ajer, por vetem aromat te cilat vijne nga kafshet. Per kete subjekti ne kapanonin e ndertuar ka vendosur ventilatore te cilet do te bejne te mundur uljen e ketyre aromave gjithashtu edhe mosdaljen jashte perimetrit te aktivitetit.

- **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e transportit te cilat do te bejne transportin e kafsheve si dhe qumeshtit, por keto zhurma jane brenda normave te lejuara per nje aktivitet te tille.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e administratorit jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e punes jane vendosur ne vende te dukshme fikset konform rregullave te sigurise.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve, ky aktivitet nuk perdor lende te rrezikshme apo mjete te tilla te cilat te vene ne rrezik jeten e punojesve , linja teknologjike eshte e standarteve te fundit.

## 5. KONKLUZIONE

### Konkluzione

- Ky aktivitet nuk perdor lende te demshme por mbetjet dhe ujrart qe gjenerohen nga larja e ambienteve mund te demtojne rende mjedisin ne rast se shoqeria nuk do te merrte masa per menaxhimin e tyre.
- Higjena gjate proceseve te punes eshte maksimale dhe ushtrohen kontrole te vazhdueshme nga Instituti i Higjenes.
- Zbatohen ne menyre te perpikte rregullat sipas kerkesave higjieno sanitare dhe veterinare per mbajtjen e kafsheve.
- Ky aktivitet nuk ka ndikim negativ ne popullsi, nuk prek zona te mbrojtura, objekte te rendesise se vecante.
- Gjate aktivitetit nuk ka ndotje te tokes pasi subjekti ka marre masa per menaxhimin e mbetjeve, ujerave duke i derdhur ne rrjetin e zones dhe ajrit duke instaluar nje sistem ventilimi per largimin e aromave .
- Per nje siguri maksimale zbatohen, ne menyre te perpikte, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes kunder zjarrit.
- Aktiviteti nuk ka efekte anesore ne mjedis dhe me masat e marra nuk ka premisa qe te sjelle ndotje mjedisit apo pasoja negative per shendetin e njerezve te flores dhe faunes.

Punoi: ” **Eko Studio projekt** ” shpk

